

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS KOSOVSKA AGENCIJA ZA UPOREDIVANJE I VERIFIKACIJU IMOVINE KOSOVO PROPERTY COMPARISON AND VERIFICATION AGENCY			
DATE: PRANUAR/DORËZUAR DATUM: PRIMLJEN/DOSTAVLJEN DATE: RECEIVED/SUBMITTED			
18 / Jan / 19 V.G			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shit. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages
ZE	I	00052/19	4



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS-KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA	
Nr./Br.	01/80/19
Nr. i fq./Br. str.	
Data/Datum:	18.01.2019
PRISHTINE-PRISHTINA	

Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo



AGJENCIA KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS
 KOSOVSKA AGENCIJA ZA UPOREDIVANJE I VERIFIKACIJU IMOVINE
 KOSOVO PROPERTY COMPARISON AND VERIFICATION AGENCY



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/
 Ministry of Environment and Spatial Planning



Por: uporedivanje i prones/ pronate - Za verifikaciju prisutnosti imovine - For prones/ prisutnosti verifikaciju

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVO CADASTRAL AGENCY

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
 MES
 AGJENCISË KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË
 PRONËS
 DHE
 AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

Mbi bazën e autorizimeve të dhëna sipas Ligjit Nr.05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronë dhe Ligjit Nr. 04/-L-013 për Kadastër, si dhe të gjitha akteve tjera nënligjore, që burojnë nga këto ligje.

Palët e kësaj marrëveshje:

I. *Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP)*, me adresë në Rr. "Perandori Justinian", Nr.71, Prishtinë, të cilën e përfaqëson Znj. Florije Kika U.D. Zëvendës Drejtor;

dhe

II. *Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK)*, me adresë në Rr. "Çlirimi", Nr. 25, Ndërtesa e Arkivit/Kati II, Prishtinë, të cilën e përfaqëson Z. Avni Ahmeti U.D. Drejtor i Përgjithshëm.

U dakorduan për nevojën e përcaktimit të modaliteteve të bashkëpunimit në mes tyre me qëllim të zbatimit të ligjeve të cekura më lartë dhe veçanërisht me qëllim të zbatimit të procesit të krahasimit dhe verifikimit sipas Ligji Nr.05/L-010, si në vijim:

F.K.

A.A.

Neni 1 QËLLIMI

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi (Marrëveshja) është të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë e palëve nënshkruese AKKVP-së dhe AKK-së, me qëllim të sigurimit të rrjedhës efikase të të dhënave, ndërmjet këtyre dy Agjencive për të mundësuar zbatimin e procesit të verifikimit dhe krahasimit.

Neni 2 PËRGJEGJËSITË E AKK-së

- 2.1. AKK do ti sigurojë AKKVP-së qasje të plotë dhe pa pagesë, në të gjitha të dhënat kadastrale qofshin ato dosje fizike apo në formatin elektronik, duke përfshirë shfrytëzimin e bazës elektronike të të dhënave tekstuale dhe grafike për tërë territorin e Kosovës, e që mbahen nga AKK-ja apo Zyrat Kadastrale Komunale (ZKK), me qëllim të zbatimit të mandatit të AKKVP-së të përcaktuar me Ligjin Nr.05/L-010;
- 2.2. AKK-ja me qëllim të efikasitetit të procesit të krahasimit dhe verifikimi, përmes ndërlidhjes së sistemeve do t'i ofrojë AKKVP-së qasje për shikim dhe shtypje në të gjitha aplikacionet elektronike, prej nga mund të shikohen dhe shtypen të dhënat grafike dhe tekstuale, duke përfshirë, por mos u kufizuar edhe aplikacionin për gjeoreferencimin e planeve;
- 2.3. AKK-ja do të udhëzojë ZKK-të, të kryejnë matje dhe identifikim të pronave objekt të krahasimit dhe verifikimit, në të gjitha rastet kur kjo mund të jetë e nevojshme;
- 2.4. AKK-ja do të trajtojë punonjësit e AKKVP-së në përdorimin e bazës së të dhënave tekstuale dhe grafike, duke përfshirë edhe aplikacionet elektronike;
- 2.5. AKK-ja dhe ZKK-të, do të caktojnë zyrtar të cilët do të jenë pikë kontakti me AKKVP-në.

Neni 3 PËRGJEGJËSITË E AKKVP –së

- 3.1. AKKVP-ja pas procesit të krahasimit dhe verifikimit do ti dërgojë AKK-së vendimin përfundimtar të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije për Prona, së bashku me dosjen e dokumenteve kadastrale të kthyer nga Serbia, me qëllim të implementimit të vendimit në regjistrin kadastral;

- 3.2. AKKVP-ja në të gjitha rastet kur pas procesit të krahasimit dhe verifikimit nuk gjen dallime apo mospërputhshmëri, vendimin e Sekretarisë Ekzekutive së bashku me dosjen e njësive kadastrale, në lidhje me të cilën është përfunduar ky proces, do ta dërgojë në AKK në një afat të shkurtër, me qëllim të plotësimit të regjistrit kadastral.
- 3.3. AKKVP-ja do të zhvillojë procesin e krahasimit dhe verifikimit me prioritet, në zonat në të cilat AKK-ja apo ZKK-të janë në proces të rindërtimit të të dhënave kadastrale.
- 3.4. AKKVP-ja do të trajtojë punonjësit e AKK-së në rast nevojë.
- 3.5. AKKVP-ja do të përdorë të gjitha të dhënat e pranuar nga AKK-ja në harmoni të plotë me ligjet e aplikueshme dhe nuk do t'ju ofrojë palëve të treta, përveç në mënyrat e parapara me ligjet në fuqi.

Neni 4

MOSMARRËVESHJET EVENTUALE

AKKVP dhe AKK, pajtohen se për çdo mosmarrëveshje apo keqinterpretim lidhur me natyrën dhe qëllimin e bashkëpunimit që del nga kjo Marrëveshje, do ta zgjedhin përmes bisedimeve dhe mirëbesimit të ndërsjellët duke respektuar Ligjin Nr.05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronë, apo edhe ligjet tjera në fuqi.

Neni 5

ZBATIMI

- 5.1. Palët pajtohen se do të kujdesën për zbatimin me përkushtim dhe përpikëri të kësaj marrëveshje.
- 5.2. Modalitetet e qasjes në të dhëna do të përcaktohen me detajisht në mes AKKVP-së dhe AKK-së pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje duke marrë parasysh kërkesat e të dy palëve për sigurinë e informatave dhe integritetin e rrjetit.

Neni 6

VLEFSHMËRIA KOHORE E MARRËVESHJES

Palët nënshkruese pajtohen që vlefshmëria kohore e kësaj marrëveshje të jetë deri në përfundimin e procesit të krahasimit dhe verifikimit, ndërsa ndryshim-plotësimi mund të bëhet në çdo kohë vetëm me kërkesë me shkrim të parashtruar nga palët nënshkruese, kurse në rast të ndryshimit të kornizës ligjore ndryshimi është i domosdoshëm.

F.K.

A.A.

Neni 7
NËNSHKRIMI DHE HYRJA NË FUQI

Marrëveshja është nënshkruar në dy (2) kopje identike origjinale, nga një (1) kopje për secilën palë nënshkruese dhe e njëjta hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dy palët.

Nënshkruar me datë: 18.01.2019 në: PRISHTINË

**PËR AGJENCIA KOSOVARE PËR
KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS**

Znj. Florije Kika
U/D Zëvendës drejtor Ekzekutiv




**PËR AGJENCINË KADASTRALE TË
KOSOVËS**

Z. Avni Ahmeti
U/D Drejtor i Përgjithshëm


